



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KONKURENCËS**  
**KOMISIONI I KONKURENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 589, Datë 31.01.2019**

**“Për miratimin e Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2018 dhe prioritetet kryesore për vitin 2019”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 31.01.2019, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Miratimin e Raportit Vjetor të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2018 dhe prioritetet kryesore për vitin 2019

**Baza Ligjore:** Neni 24, shkronja (d) dhe (e), neni 26 dhe nenin 29, pika 2, shkronja (ç) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Draft Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2018 dhe prioritetet kryesore për vitin 2019

**VËREN SE :**

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në nenin 29, pika 2, shkronja (ç) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, ka depozituar Draft-Raportin Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2018 dhe prioritetet kryesore për vitin 2019.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe (e), nenin 26 dhe nenin 29, pika 2, shkronja (ç) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar ;

## **VENDOSI:**

1. Miratimin e “Raporti Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2018 dhe prioritetet kryesore për vitin 2019”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**